



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivroy	09.10.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKIMSHCK	6431/2023		119



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1152/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Vjollca Sinani- Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1152/2023 të datës 11.09.2023 e parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/ Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.10.2023, mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1152/2023 e datës 11.09.2023 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi me datën 11.09.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6048/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër njoftimit të datës 04.09.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit për shkak të shkeljes së Ligjit me Nr. 05/L-031 për Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe atë nenin 98 ,paragrafi 2 të këtij ligji si dhe veprimeve tjera administrative që ndërliiden me çështjen e datës së njoftimit për shpalljen e konkursit, duke përfunduar me çështjen e njoftimit të fundit të datës 05.09.2023 sa i përket rezultatit përfundimtar të vlerësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 12.09.2023,përmes shkresës me numër protokollit 6048/2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa pas tërheqjes së ankesës nga ankuesi me datë 14.09.2023 përmes emailit [ankesa.kpmschck@rkt-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rkt-gov.net) kemi njoftuar organin e punësimit përmes emailit të datës 14.09.2023 që nuk ka nevojë për përcjelljen e përgjigjes në ankesë.



Ankuesi me datë 14.09.2023 përsëri përmes adresës elektronike [ankesa.kpmschck@rkt-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rkt-gov.net) ka dërguar emailin me pretendimet ankimore se iu është hakuar emaili dhe se nuk qëndron prapa emailit të datës 13.09.2023 për tërheqje të ankesës, duke kërkuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të trajtoj ankesën e dorëzuar më datë 11.09.2023..

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi po ashtu edhe emailin e datës 14.09.2023 në adresën zyrtare [ankesa.kpmschck@rkt-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rkt-gov.net), dhe përsëri me datë 15.09.2023 ka përcjell kërkesë për përgjigjeje në ankesë në Komunën e Prizrenit për ankuesin ,kurse e njëjta këshillit i ka dërguar përgjigjen në ankesë më datë 29.09.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e trajtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën, A.nr.1152/2023 të datës 11.09.2023 me numër protokollit 6048/2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emali i datës 11.09.2023; Kërkesa për përgjigje e datës 12.09.2023; Emali i datës 14.09.2023; Tërheqje e ankesës e datës 14.09.2023; Ankesës e datës 15.09.2023; Përgjigjeje në kërkesë e datës 29.09.2023 me numër protokollit 1152/2023; Konkursi për Specialist të Inxhinierisë së Ndërtimit i datës 30.05.2023; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ; Njoftimi i datës 30.06.2023 nga MBNJ; Njoftimi i datës 17.07.2023 nga MBNJ; Njoftimi për përfundimin e vlerësimit dhe shpalljen e rezultateve me fitues për pozitën zyrtar i lart për ndërtimtari profesionale 1, në kuadër të grupit specialist të inxhinierisë të ndërtimit i datës 05.09.2023 nga NJBNJ; Renditja përfundimtare e kandidatëve në SIMBNJ; Lista e kandidatëve të pranishëm në Intervistë e datës 25.08.2023; Vendimi me Nr.RN00009222/01 i datës 14.06.2022; Njoftim për ankuesin; Vendim i datës 30.06.2022; Ankesa e ankuesit KM, për Komunën e Prizrenit e datës 03.07.2023; Trusti për periudhën 28.06.2011-27.06.2023; Vendim i datës 07.07.2022 nga NJBNJ; Formular për kërkesë apo ankesë e datës 08.09.2023; Ankesë me nr.01-111/01-0130721/23 e datës 08.09.2023; Kopja e letërnjoftimit e ankuesit; Vendim i datës 14.09.2023 nga Kryetari i Komisionit; Vendim i datës 10.08.2023 nga NJBNJ; Vendim i datës 21.02.2023 me nr.01-030/01-0025891 nga Kryetari i Komunës së Prizrenit; Emali i datës 20.09.2023 nga ankuesi për NJBNJ; Kopja e Diplomës së ankuesit e datës 01.09.2011 me nr.472; Vërtetim i kopjes nga Noteri; Referencë nga N.N.Sh."THEMELI" e datës 02.05.2015; Letër Referencë nga N.P.N."PROING" e datës 04.09.2017; Referencë nga N.N.Sh."THEMELI" e datës 03.05.2021; Referencë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit e datës 30.09.2020; Referencë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit e datës 17.05.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar nga se është e parakohshme, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton faktin se ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e parashtron kundër njoftimit të datës 04.09.2023 të nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit në lidhje afatin për zgjatjen e procedurës si dhe veprimeve tjera administrative që ndërlidhen me çështjen e datës së njoftimit për shpalljen e konkursit, duke përfunduar me çështjen e njoftimit të fundit të datës 05.09.2023 sa i përket rezultatit përfundimtar të vlerësimit, ndërsa kërkon që ky konkurs të anulohet për shkak të shkeljeve që janë bërë.



Kolegji i këshillit me rastin e vendimmarrjes në lidhje me këtë ankesë dhe duke ju referuar provave materiale, konstaton se më datë 30.05.2023 është publikuar konkursi me Nr të Referencës RN00011776 për grupin "Specialit të Inxhinierisë të Ndërtimit" pozita "Zyrtar i Lartë për Ndërtimtari", me afat aplikimi nga data 20.06.2023 deri më datë 27.06.2023. Më datë 10.07.2023 janë publikuar rezultatet e verifikimit paraprak ku në mesin e kandidatëve është edhe ankuesi, ndërsa pas këtij procesi është mbajtur testi me shkrim më datë 03.08.2023. Më datë 10.08.2023 është vendosur për shtyrjen e afatit të zhvillimit të procedurës nga data 10.08.2023 deri më datë 09.09.2023.

Më datë 04.09.2023 është publikuar edhe vendimi për vazhdimin e afatit, ndërsa më datë 05.09.2023 janë publikuar rezultatet përfundimtare të pranimit duke i dhënë mundësi kandidatëve të pakënaqur që në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi mund të drejtohen me ankesë tek Komisioni i Pranimit.

Ankuesi më datë 08.09.2023 ka parashtruar ankesë në Komunën e Prizrenit respektivisht Njësine për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ndërsa në të njëjtën ditë konkretisht më datë 08.09.2023 ka parashtruar edhe ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes emailit [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net).

Kolegji i këshillit me rastin e vendimmarrjes në lidhje me ankesën ju referua nenit 16, paragrafit 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar se: "6. Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj", si rezultat i kësaj ankuesi pa kaluar ende afati për përfundimin e procedurës respektivisht afati për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Pranimit të Komunës së Prizrenit siç parashihet me dispozitën e cekur si më lartë ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke mos pasur parasysh dispozitat e nenit 31 paragrafi 1, 2, të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: "1. Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet".

Bazuar si më sipër e në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 125 paragrafi 1, me të cilin është përcaktuar se: "Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")", rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke qenë se ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa kaluar ende afati për përfundimin e procedurës, atëherë ankesa e ankuesit në këtë fazë është e parakohshme.



Marr parasysh që Komisioni i Pranimi më datë 14.09.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. RN00011776/02 përmes të cilit ankuesi i është refuzuar ankesa e parashtruar më datë 08.09.2023, atëherë Kolegji konstaton se në pajtim me afatet ligjore të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitave të nënti 31 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, pala ankuese mund të parashtroj ankesë ndaj këtij vendimi duke e kontestuar të njëjtin. Me qenë se kolegji vendosi në lidhje me ankesën si në dispozitiv të këtij vendimi prandaj nuk u lëshue në shqyrtim meritore të disa çështjeve që janë potencuar në përmbajtje të ankesës nga se nuk kanë relevanc apo që kanë ndikim për vendimmarrje ndryshe nga ky vendim.

Andaj Kolegji i Këshillit duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.1152/2023, datë 09/10/2023.

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

